

Vaksinimi kundër COVID-19 në Valoni

Cilat janë etapat e ardhshme ?

Personat mbi moshën **65 vjeç**

Personat në rrezik nga moshë 18-65 vjeç

Personat nga moshë **18 deri në moshën 65 vjeç duke filluar nga më të moshuarit deri tek më të rinjtë**

Si mund të merrni takim për t'u vaksinuar?

I. FTESA

Ftesa do t'ju dërgohet me **letër, e-mail ose me mesazh**.

Ajo shoqërohet nga një **pyetësor shëndetësor që duhet plotësuar para se të vaksinoheni**.

Në ftesë ju propozohet **vendi i vaksinimit dhe aty saktësohen mënyrat e ndryshme të marrjes së takimit si dhe kodi juaj personal me 16 karaktere**.

Ky kod është personal dhe në asnjë rast nuk mund t'i jepet dikujt tjetër.

Ftesat do të dërgohen me radhë dhe asnjë person nuk do të lihet në harresë!

2. SI MUND TË MERRNI TAKIM ?

▶ NË PËRPARËSI : NË LINJË

Në faqen e internetit www.jemevaccine.be. **Klikoni në faqen « gérer mes rendez-vous de vaccination ».** (menaxhoj takimet e mia lidhur me vaksinimin). **Bëni pastaj kodin e ftesës që ka 16 shkronja.**

Aktualisht, vakcina jepet në 2 doza. Mund të merrni **takim menjëherë për të 2 injeksionet duke marrë parasysh mundësitë e disponueshme dhe afatet e duhura ndërmjet të dyjave.**



Sapo të keni marrë takim për të 2 dozat, do të merrni konfirmim me mesazh ose me e-mail. E-mail shoqërohet me një **biletë që përmban Kodin QR që duhet ruajtur me kujdes**. Nëse i keni marrë, këto elemente duhet të paraqiten ditën e vaksinimit.

Në rast se nuk mund të shkoni, mund ta anuloni takimin me e-mail-in e konfirmimit dhe mund të merrni më pas një takim tjetër me kodin tuaj personal i cili është i vlefshëm për 30 ditë.

▶ Nuk e përdorni dot internetin?

Marrja e takimit është e mundur atëherë me telefon nëpërmjet numrit falas të regjistruar në thirrjen tuaj.

3. DITËN E VAKSINIMIT

▶ të jeni në orarin e duhur.

▶ **Merrni me vete kartën e identitetit (absolutisht e detyrueshme), letrën e thirrjes dhe nëse është e mundur, biletën dhe pyetësorin shëndetësor të plotësuar siç duhet.**

▶ Pas injeksionit, një **kohë vëzhgimi nga 15 deri në 30 minuta** është parashikuar para se të largoheni nga qendra.

▶ **Mbajtja e maskës është e detyrueshme.**



ËSHTË MIRË QË TA DINI!

Ne ju kërkojmë ne ju kërkojmë të vini vetëm përveç rastit kur keni nevojë për ndihmë për të lëvizur.

Për më shumë informacion?
je.me.vaccine.be

Keni pyetje praktike ose nevojë për ndihmë ?

Konsultoni FAQ lidhur me marrjen e takimeve!

covid.aviq.be/fr/faq-vaccination-en-pratique

